



KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEÇE ZA SNABEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.O.O.

Ministria e Elektroenergjies
Bulevardi "Bull Kuvshin" nr 3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektroenergjia (Building)
388 Cërakin Boulevard nr.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo

KESCO SH.A.
Nr. 6 Dt. 09.03.2016
HQ 1

Komentet e KESCO-s ndaj Raportit Konsultative të ZRrE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2016

Dorëzuar më 09 Mars 2016

Hyrje

Më 24 shkurt 2016 ZRrE-ja ka publikuar Raportet Konsultative (RK) për Sektorin e Energjisë, në të cilat raporte janë paraqitur rezultatet e vlerësimit dhe përshtatjeve për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për secilin të licencuar.

KESCO falënderon ZRrE-në për dhënien e mundësisë për t'iu përgjigjur çështjeve të rëndësishme të ngritura nga ZRrE-ja në Raportet Konsultative dhe kërkon nga ZRrE që pozita e KESCO-s në çështjet e ngritura të konsiderohet seriozisht para se të caktohen tarifat, të cilat pritet të hyjnë në fuqi më 01 Prill 2016.

Si gjithmonë KESCO është i gatshëm që në çdo kohë të takohet me ZRrE-në për t'i diskutuar çështjet e ngritura në RK. Për më tepër, kalkulimet në formë elektronike të tabelave do t'i dorëzohen ZRrE-së me qëllim që ZRrE t'i shfrytëzoj ato për nevojat e saj.



Balanca e Energjisë

ZRrE-ja i ka paraqitur detajet e Bilancit Energjetik në Tabelën 2 të Raportit Konsultativ (RK). Tabela 1 më poshtë jep krahasimin mes qëndrimit të KESCO-s dhe të ZRrE-së, me shpjegimet e përshtatjeve të ZRrE-së, sa i përket asaj që KESCO ka mundur të përcaktoj nga RK.

Balanca e Energjisë 2016			
	KEDS	ZRrE	
Përshkrimi	GWh	GWh	Diferenca
TC A (prodhimi ne prag)	1,983.4	1,983.4	-
TC B (prodhimi ne prag)	3,687.5	3,687.5	-
Rishikim i prodhimit te KEK	(120.0)	(120.0)	
Për Termokos	(38.7)	(38.7)	-
Gjenerimi bruto	5,512.2	5,512.2	-
Ujmani dhe BRE në nivel të transmisionit	158.2	158.2	-
Hyrja ne transmision	5,670.4	5,670.4	-
Import	661.3	661.3	-
Ne disponim	6,331.7	6,331.7	-
Konsumatorët 220/110 kV	677.2	677.2	-
Mihjet	121.0	121.0	-
Shpenzimi vet. nga Transmisioni	152.0	152.0	-
Rrjeti Distributiv	4,299.6	4,206.2	93.6
Konsumi neto-max	5,249.8	5,156.3	93.6
Humbjet ne bartje	114.0	114.0	-
Konsumi bruto	5,363.8	5,270.3	93.6
Eksporti	967.9	1,061.5	(93.6)
Teprica-Mungesa	-	-	
Hyrja ne distribucion	4,299.6	4,206.2	93.6
Gjenerimi ne nivel te OSSH	64.2	64.2	-
Ne disponim	4,364	4,270.4	93.5
Humbjet teknike dhe komerciale	924.3	830.9	93.5
Humbjet teknike dhe komerciale (%)	22.43%	20.63%	1.8%
Veriu	243.3	243.3	-
Shitjet ne OSSH	3,196.2	3,196.2	-
Shitjet totale në FPEE	3,873.4	3,873.4	-

Tabela 1

KESCO ka vërejtur nga raporti konsultative se prodhimin të KEK-ut është ulur 120 GWh në prodhimin bruto të tij. Për të qenë më qartë në tabelën më sipër ne kemi shtuar një rresht "*Rishikimi i prodhimit të KEK-ut*" me qëllim që të arrijmë në nivelin e njëjtë të volumeve të eksportit ashtu siç e ka paraqitur ZRrE-ja në RK.

Parashikimi i Balancës së Energjisë, përkatësisht blerjet e energjisë me shumicë janë rishikuar të reflektojnë kërkesën e KEDS për rishikimin e caktimit të humbjeve, të cilat i konsideron si humbje të trashëguara të KEDS-it prej 1.8%. Kjo përshtatje është reflektuar gjithashtu në volumet e eksportit, meqë eksporti paraqitet si numër balancues nga ZRrE-ja.

Kostot e Energjisë me Shumicë

KESCO pajtohet me qëndrimet e ZRrE-së për kalkulimin e kostove të energjisë me shumicë, por shqetësimin e vetëm e ka lidhur me volumin dhe çmimin e eksportit. Në seksionin në vijim është paraqitur këndvështrimi i KESCO lidhur me volumet dhe çmimin e eksportit.

Niveli i eksportit

Siç mund të shohim nga tabela e mësipërme, ZRrE-ja ka reduktuar sasinë e prodhimit për 120 GWh. ZRrE me të drejtë ka përdorur eksportin si vlerë balancuese për mungesën e prodhimit të energjisë, sidoqoftë KESCO vlerëson se vlera e eksportit e paraqitur nga ZRrE është e mbivlerësuar duke pasur parasysh: (i) vonesat e futjes në operim dhe jo-stabilitetin e njësive gjeneruese të TC A-së, (ii) riparimeve të pritshme të TC B-së, si dhe (ii) faktit se pjesa më e madhe e eksportit duhet të bëhet gjatë orëve jashtë pikut, respektivisht gjatë orëve 00:00 deri 06:00, eksport që bëhet me çmime shumë të ulëta. Operimi i njësive gjeneruese është delikat andaj

Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë		SHTE10 RK	KECO Propozimi
Prodhimi vendor		2016	2016
KEK Gjenerimi	€/MWh	28.03	28.03
	€000s	146,882	146,882
HC Ujmani dhe BRE tjera të kyçura në nivel transmisioni	€/MWh	41.8	41.8
	€000s	6,614	6,614
Gjenerimi i kyçur në nivel të distribucionit (mesatar)	€/MWh	57.5	57.5
	€000s	3,695	3,695
Importi			
Importet e kontraktuara	GWh	661.3	661.3
	€/MWh	51.8	51.8
	€000s	34,226	34,226
Eksporti			
Eksportet t e kontraktuara	GWh	1,061.3	967.9
	€/MWh	28.0	28.0
	€000s	29,759	27,139
Kostot e energjisë me shumicë			
KEK Gjenerimi	€000s	146,882	146,882
Gjenerimi tjetër vendor	€000s	10,308	10,308
Importi	€000s	34,226	34,226
Total blerjet e energjisë me shumicë	€000s	191,417	191,417
Eksporti	€000s	-29,759	-27,139
subvencionet	€000s		
WHEC + WHCC	€000s	161,658	164,278
Marzha me pakicë			
Marzha me pakicë	%	3%	3%
Kostot e marzhës me pakicë	€000s	4,850	4,928
WHPC	€000s	166,508	169,206
WHPCat-1 - WHPCft-1	€000s	5,187	5,187
Të hyrat e parregulluara për nivelin e humbjeve të tejkaluara			
It	%	9.14%	9.14%
(WHPCat-1 - WHPCft-1)*(1+It)	€000s	5,661	5,661
WHPCf	€000s	172,168	174,867
Mesatarja e Ponderuar e Kostos së blerjes së energjisë (WHEA)	€/MWh	34	34

Tabela 2

Kostot Operative

Gjatë analizimit të raportit konsultativ KESCO ka vërejtur se në këtë shqyrtim ZRrE ka aplikuar faktorin e efikasitet ndaj total OPEX-it të aprovuar për vitin 2015, ndërsa në modelin¹ e përdorur nga ZRrE për këtë periudhë rregullative faktori i efikasitetit për Furnizuesin Publik (KESCO) është zero.

KESCO gjithashtu ka vërejtur se gjatë kalkulimit të nivelit të OPEX-it ZRrE në këto kosto ka përfshire edhe kostot që kanë të bëjnë me zhvlerësimin e lejuar, dhe në këtë kuptim niveli i lejuar i OPEX për KESCO në realitet është 6.14 mln€ dhe jo 6.50 mln€ siç është paraqitur në raportin konsultativ.

Bazuar në atë që u tha më lartë KESCO beson se duhet rishikuar propozimi fillestar për kostot e OPEX-it të propozuar nga ZRrE-ja nga 6.14mln€ në 6.44mln€.

Përshtatjet për KREV

Në vlerësim e të hyrave të lejuara maksimale për FPEE-në, ZRrE ka zbritur në total të hyrat që kanë të bëjnë me rikthimin e humbjeve, të cilat janë reflektuar në KREV-in përfundimtar. Sidoqoftë, lidhur me këtë çështje KESCO dëshiron të ngre shqetësimin e saj se jo e gjithë sasia e energjisë së faturuar si " rikthimin i humbjeve" do të arkëtohet nga konsumatorët të cilëve i është lëshuar fatura për rikthimin e humbjeve për faktin se:

- Konsumatorët mund të ankohen në instancë të parë në ZRrE dhe më pastaj edhe në Gjykatë, andaj varësisht nga vendimi final jo e gjithë energjia e faturuar për këtë qëllim mund të lejohet t'ju faturohet konsumatorëve, përkatësisht kjo paraqet një vlerë diskutabile dhe një procedurë të gjatë kolektimi.

¹ ERO MYT - Summary Model - v29_220313 (2)

- Vetëm një vlerë e vogël, afro 20% e energjisë së faturuar në emër të rikthimit të humbjeve inkasohet.

Duke pasuar parasysh se natyra e këtyre kostove ka të bëjë kryesisht me keqpërdorimin e energjisë, kërkojmë nga ZRrE që të bëjë përshtatjet e MAR-it të FPEE-së lidhur me kostot që kanë të bëjnë me rikthimin e humbjeve, respektivisht të ulen këto kosto vetëm për 50%, ngase përjashtimi në tërësi i këtyre kostove nuk paraqet më motiv për të për reduktimin e humbjeve që kanë ndodhur në të kaluarën.

Të Hyrat Maksimale të Lejuara për KESCO

Tabela në vijim paraqet rishikimin final të MAR-it të KESCO-s pasi janë marr parasysh përshtatjet e nevojshme për kostot me shumicë dhe përshtatjet tjera të argumentuara më lartë, së bashku me kostot e komponentëve tjera të Furnizuesit Publik, të cilat ndryshojnë automatikisht siç janë borxhi i keq dhe kapitali punues.

MAR i FPEE-së		SHTË10 RK	KECO Propozimi
Parametrat e indeksimit			
It	%	9.14%	9.14%
Kostot e lejuara me pakicë (RETRt - Neni 10 Rregulla e çmimeve të FPEE-së)			
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	6.1	6.4
$DEPCt = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.4	0.4
Kostot e bartura (PSTCt)			
Kostot e OST-së	€m	17.6	17.6
Kostot e OSSh-së	€m	74.9	83.7
Të hyrat nga shitja e humbjeve nga OST dhe OSSh			
Të hyrat OST (t)	€m	3.9	3.9
Të hyrat OSSh (t)	€m	28.3	31.4
Të hyrat OST (t-1)		0.0	0.0
Të hyrat OSSh (t-1)		4.6	4.6
Kostot e Kapitalit Punues (WCLCt)			
$WCLC = (1/12) * It * (RETRt + WHPCt + PSTCt - NTFRt)$	€m	1.7	1.9
Kostot e Energjisë me shumicë (WHPC)			
WHPC	€m	172.2	174.9
Marzha me pakicë	€m		
Përshtatjet e marzhës me pakicë	€m		
Taksa e licencës			
Taksa e licencës	€m		
Të hyrat jo-tarifore (NTFR)			
Të hyrat jo-tarifore (NTFRt)	€m		
Borxhi i keq i lejuar (BDTA)			
BDTA	%	4%	4%
BDTA	€m	9.7	10.2
BDTA përshtatjet	€m		
KREVT			
KREVT i FPEE-së	€m	3.7	6.0
KREVT i OSSh-së	€m	4.1	4.1
KREVT i OST-së	€m	2.2	2.2
Përshtatjet tjera			
Përshtatjet	€m		
MAR-i i FPEE-së			
MAR i FPEE-së	€m	243.4	254.5

Tabela 3